



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **144**

Prishtinë, më 8.4.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi.

Mungoi : Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 1.4.2014,
3. Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013, i ftuar Ministri i mjedisit.
4. Konfirmimi për leximin e dytë për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimi i bujqësisë, i ftuar Ministri i bujqësisë.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me shtesë për shqyrtimin e projektligjit për zhurmën në pikën të ndryshme.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.4.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 1 prill 2014.

3. Raporti vjetor i Agjencisë për komplekse memoriale

Kryetari Nait Hasani përshëndeti **Ministrin Gashi** i cili rregullisht dhe me transparencë i përgjigjet ftesave nga ky komision. Ai shkurtimisht rikujtoi takimin e fundit të komisionit ku drejtori i agjencisë z. Blakaj ka arsyetuar raportin vjetor i cili raport ka pasur si paqartësi ashtu edhe dilema. Së pari, vazhdoi, fjala është për kompetenca jo të plota të agjencisë ndaj me rastin e mbledhjes së mbajtur, komisioni nuk ka krijuar ende pasqyrën e plotë dhe bindjen se a mund të procedohet ky dokument për miratim në mbledhjen plenare pa i sqaruar detalet në hollësi, ngase në disa momente shpjegimet e dhëna më tepër kishin të bënin ma tepër për punët biznesore sesa me punët që i takojnë një agjencie. **Sevdije Lama** ndërhyri me pyetjen : pse nuk është drejtori i agjencisë në këtë mbledhje. **Kryetari Nait Hasani** : u përgjigj se nuk deshti komisioni të krijoj në këtë mbledhje situat konfliktuoze por së pari duhet të shikohet transparenca e MMPH.

Ministri Dardan Gashi fillimisht falënderoi dhe shprehu respektin për komisionin çka nuk shprehu edhe për raportimin e mbledhjes së kaluar nga përfaqësuesi i agjencisë. Ai tha se ministria edhe më heret ka desht që ta heq këtë lëmi nga vedi ngase nuk i takon fushës profesionale si dhe prej kujdesit që mos të krijohen situata politike në MMPH. Pse nuk funksionalizohet sot kjo agjenci, është pyetje që nuk i takon MMPH por e vërteta është se kjo ministri i ka kryer obligimet që i takojnë si për puntorë (transferimi nga MMPH i tre punëtorëve) ashtu edhe për projekte (të cilat kanë mbetur në MMPH disa për shkak të jokonsolidimit të Agjencisë), ndaj sa i përket raportit me shkrim ai sugjeroi komisionit që dy faqet rreth sfidave të hiqen nga raporti. Nuk është ky organ (agjencia) i cili do të vërtetoi dilemat rreth akuzave apo dyshimeve për korrupsion, përfundoi.

Faton Topalli : raporti paraqet një shkresë me pretendime dhe shpjegime të rënda (akuza për korrupsion), ndaj a mundemi me ardhë deri te e vërteta, a kemi të bëjmë me gabime personale apo të tjera gabime ?

Afërdita Berisha : në disa pyetje që janë parashtruar duhet të epen përgjegjet (pse vetëm projekti Prekazit, pse ciceronët nuk paguhen etj) dhe kërkesa për largimin e dy faqeve nga raporti duhet mirë të sqarohen, ngase komisioni duhet të rekomandoi mbledhjes plenare, por para kësaj të sqarohen të lartcekurat. Komisioni mund të ftoi drejtorin dhe të kërkoi përmirësime në raport apo plotësime, por jo të largoi atë çka është shkruar nga organi kompetent.

Nijazi Idrizi : raporti është përshkrues por edhe i sinqert, ashtu si thash në mbledhjen e kaluar, ndaj duhet të përgëzohet raportuesi për guximin e treguar për shpalljen e gjërave që ende nuk dihet sa janë të vërteta, sa i përket heqjes së faqeve nga raporti mendoj se ajo nuk na takon neve, ngase ato të dhëna në fazat e mëvonshme do të biejnë në përgjegjësinë personale të raportuesit. Mendoj se pyetjet e parashtruara në raport rreth kompletimit të vendeve të punës dhe projekteve të vazhduara apo jo, nuk janë mjaft të sqaruara.

Faton Topalli : pse në dhjetor 2013 janë bërë marrëveshjet e reja përkatësisht janë nënshkru kontratat e reja ?

Nait Hasani desha një sqarim : Kompleksi i Adem Jasharit është projekt i veçant dhe me ligj të veçantë, ndaj nuk ka pasur mundësi me u ndalë.

Ministri Dardan Gashi : problemi qëndron te alokimi nga Kuvendi me rishikim buxhetor (Komisioni për buxhet) i këtyre financave në MMPH për ti kryer më shpejt punët, sepse agjencia nuk ka qenë e funksionalizuar. Asnjë alokim nuk është bërë jashtë Kuvendit.

Salih Morina : kërkoi falje për vonesë në këtë mbledhje, falenderoj ministrin për këtë pjesmarrje në komision, shpresoj që do të sqarohen dilemat e shfaqura në mbledhjen e kaluar ngase poçes nuk sqarohen, pyetjet sa vijnë e shtohen në punën e mëtejme.

Arben Çitaku : projekti Adem Jashari për ne në MMPH nuk ka qenë i kontraktuem ndaj kemi përcjell deri në muajin 6 2013 agjencisë 1 milion dhe 3 punëtorë, pse nuk ka kapacitete agjencia nuk mund të japim përgjegje ne , ai është desht të marr ende punëtorë por ne nuk dijmë pse nuk i ka mar, ndërsa për të gjitha pyetjet që i takojnë MMPH na jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Faton Topalli : kemi themelmu një agjenci me një njeri pa i dhënë mjete, para as personel, këtu qëndron problemi, qysh të dalim nga kjo ?

Nait Hasani : qysh atëherë kur u miratua ligji në komision, kemi bërë me dije që agjencia nuk do të ketë mundësi të ketë të gjitha, por vazhdimisht do të konsolidohet, derisa drejtori i tanishëm atëherë ishte koordinator i projektit të Prekazit pranë zyrës së kryeministrit.

Afërdita Berisha : të gjitha sqarimet janë dhënë atëherë në prezencën e drejtorit të tanishëm.

Komisioni zhvilloi edhe disa konsultime të njëpasnjëshme të cilat rezultuan me :

P Ë R F U N D I M

1. Për mbledhjen e radhës të ftohet edhe një herë Drejtori i Agjencisë për sqarime të mëtejme derisa të krijohen kushtet për sjelljen e rekomandimit nga ana e komisionit rreth raportit një vjeçarë.

2. Gjithashtu për mbledhjen e radhës të ftohen zyrtarët e ZRRUK rreth raportit një vjeçarë.

3. Rreth iniciativës së Sevdije Lamës për vizita në 7 qendra të Kosovës, për njoftimin rreth zbatimit të ligjeve, u vendos që të hënën më 14 prill 2014 të vizitohet Komuna e Rahovecit dhe Gjakovës.

4. Rekomandimet për Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma

Kryetari Nait Hasani në prezencën e ministrit dhe sekretarit ftoi komisionin rreth votimit të vërejtjeve për projektligjin në fjalë, ndaj ato u votuan për komisionet e përhershme pa ndonjë ndryshim ashtu si u votuan në mbledhjen e parafundit me 10 amendamente.

5. Regjistrimi i Bujqësisë

Lidhur me këtë pikë prezantuan zyrtarët e MB me **Kapllan Halimin**-sekretar, i cili konfirmoi për komisionin se data përfundimtare për regjistrimin e bujqësisë sipas grupit punues udhëhequr nga Edita Tahiri-zv.kryeministre, do të jetë data 1-20 nëntor 2014 pa marr parasysh a mbahen apo jo zgjedhjet parlamentare.

Kryetari Nait Hasani konstatoi se Kuvendi përkatësisht Komisioni miraton këtë sugjerim dhe nuk e merr përgjegjësin lidhur me këtë datë rreth humbjes apo jo të donatorëve, ndaj në rekomandimin final për këtë projektligj data e cekur më lart do të shënohet në vend të asaj mëparme, dhe do të përcjellët për leximin e dytë.

Në pyetjen e kryetarit pse vonohet nga MB Ligji për pyje, sekretari konfirmoi për fund të prillit dhe shtoi se ka pasur punë shtesë për shkak të kthimit të ligjit nga Kuvendi një vit më parë, ndërsa rreth pyetjes për APK dhe pyetjen e parashtruar nga komisioni rreth pronësisë së dhënë me qira, gjithashtu konfirmoi gadishmërinë për raportim në çdo kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani